

STATUTI I SHOQERISE
“Mail Boxes ETC by Previsa” sh. p. k. (MBE by Previsa)

Ne kete statut

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14. 04. 2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;

KREU I

Neni 1:

Shoqeria “Mail Boxes ETC by Previsa” sh.p.k eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 2:

Objekti

Shoqeria kryen aktivitetet e meposhteme:

- Shërbime Postare
- Shërbime printimi profesionale dhe fleksibël në media cilësore të menaxhuara nga personel i specializuar me përdorimin e pajisjeve dhe teknologjive inovative.
- Mbështetje e biznesit me marketing dhe komunikim, të përshtatura nga ekspertët e MBE.

Neni 3:

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

Neni 4:

Selia

- (1) Tirane Kashar KASHAR Rruga Monum, Katund i Ri, Zone Kadastrale 2119, Pasuria nr.203/22, volumi 11.



KREU II

Kapitali

Neni 5:

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1000 leke

1. Ortaku themelues, VISAR REXHEPI: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i perket ortakut ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa kohe nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.



KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8:

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) Ndryshimin e statutit;
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- h) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- j) Riorganizim dhe prishjen e shoqerise;
- k) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- l) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.


Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9:

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese ose mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 ditet perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.



Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithet ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavarsisht parregullsise.

Neni 10:

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te votoje per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11:

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) Percaktimin e shperblimeve;
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjet e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave proceduriale dhe mbledhjeve te asamblese.

Cdo ndryshim statuti duhet te dorezohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12:

Perjashtime nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e veprimtarise se tij;
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
 - c) Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
 - d) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13:

Administrimi

- (1) Asambleja e pergjithshme emerom nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas perezaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administrator te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e Asamblese se Pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:

dhe specifitime te nenshkrimt:

- Visar REXHEPI
- Rr: "Mine Peza" 162, Tirane

- 

Neni 14:

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet dhe shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

- f) Kryejne rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) Kryejne detyrat e tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria, brenda 2 viteve te para te regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emerom me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorin, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas depozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15:

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendimi;



- d) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ate te shoqerise;
- e) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
3. Nese administratori vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo perfitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidarere.
4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersizim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen keto veprimet e meposhteme:
- a) U kthen ortakeve kontributet;
 - b) U paguan ortakeve interesa apo dividend;
 - c) U shperndan aktivet shoqerise;
 - d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
 - e) Jep kredi;

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne menyre ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.



KREU IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16:

Viti Financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17:

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate gjithhevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte i ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V

Prishja – riorganizimi i shoqerise

Neni 18:

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3. 5. 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- e) Me vendim te gjykates.

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".



Neni 19:

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14. 04. 2021 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 20:

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozita e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21:

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Mail Boxes ETC by Previsa SH. P. K.

VISAR REXHEPI

